



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 30.10.2014,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Qendron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Laura Zherka (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Islam Pacolli, shef i GP (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinofci, shef i GP (AAK-LDD), Besa Rafuna (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), dhe Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

Munguan: Hasime Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Rita Begolli (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP (LB) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësuesit e KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, dhe njëherësh i njoftuar të pranishmit se në rend dite janë paraparë edhe tri pika të tjera për diskutim.

Pikat e propozuara që të futen në rend dite për diskutim, ishin: *Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2014; Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemaljlit dhe Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Osman Dumoshit, si dhe heqjen nga rendi i ditës të Propozimvendimit*

për dhënien e pëlqimit për ndryshime në Planin rregullues të lagjes "Mati 1", në Prishtinë, për të cilat Kryetari dha sqarime të nevojshme.

Për këtë mbledhje, kryesuesi propozoi këtë:

R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;
2. Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2014;
3. Propozim vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia" në Prishtinë;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar tremujor, për periudhën korrik - shtator 2014;
5. Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës;
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemajlit;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Osman Dumoshit;
9. Propozimvendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko - privat;
10. Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare për studimin e natyrës në Parkun e Gërmisë;
11. Propozimrregullorja për hapjen e kutive të ankesave;
12. Informatë për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen "Dodona";
13. Informatë për fillimin e procesit edukativo - arsimor 2014- 2015;
14. Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
15. Pyetje dhe përgjigje;
16. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet lidhur me pikat e rendit të ditës, **Sami Hamiti** tha se Propozimi për ngritjen e përmendores së Osman Dumoshit, pëlqimi ka ekzistuar edhe më herët, ndërsa për ngritjen e përmendores së Isamil Qemalit, në parim të vendoset si lokacion dhe të kërkohet pëlqimi brenda pjesës së Universitetit. Po ashtu, kërkoi nga Kryetari që rendi i ditës të jetë i kompletuar me kohë.

Ylli Hoxha paraqiti kërkesën që, për mbledhjet e radhës së Kuvendit të jenë me më pak pika, sepse pjesa e fundit e ditës po bëhet e lodhshme dhe një pjesë e asamblistëve po e lëshojnë sallën dhe po humb kuptimi i debatit të cilin duhet ta ketë asambleja e qytetit.

Kryesuesi tha se këtë propozim do ta kemi parasysh, që rendi i ditës të jetë sa më i arsyeshëm.

Shemsi Veseli bëri vërejtje rreth Propozimvendimit për rishikimin e buxhetit, duke thënë se për këtë pikë si GP nuk kemi qenë të njoftuar.

Kryesuesi kërkoi nga GP i PDK-së, që ta propozon një anëtarë nga radhët e grupit për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Shemsi Vaseli tha se në bazë të Udhëzimit administrativ për rregullimin e komiteteve, mendoj se PDK-së i takojnë dy anëtarë e jo një.

Lirak Çelaj theksoi se për mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa nuk kemi qenë të njoftuar, andaj ne në këtë komitet do të marrim pjesë si anëtar i rregullt e jo si vëzhgues vetëm deri në muajin janar 2015.

Kryesuesi tha se Lirak Çelaj do të jetë anëtar i rregullt i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Me shumicë votash, u konstataua se Lirak Çelaj nga radhët e subjektit politik të PDK-së, do të jetë anëtar i rregullt i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Sofie Bunjaku shprehu pajtimin e grupit parlamentar për rendin e ditës, por me një vërejtje të vogël që herave të tjera ndryshimet mos të bëhen brenda mbledhjes, pra kësaj çështje në të ardhmen t'i kushtohet kujdes më i madh.

Me ndryshime dhe plotësimet e propozuara, u konstatua se me shumicë votash aprovohet rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë.

Ylli Hoxha bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e tretë "Propozimbuxheti për vitin 2015 dhe korniza afatmesme buxhetore 2015 - 2017", duke shtuar se në proces nuk reflektohet qëndrimi i LVV-së, andaj konsideroj se duhet të përmirësohet.

Agim Gashi, vëretje bëri në pikën e trembëdhjetë, duke cekur se në proces është thënë e kundërta, andaj dhe duhet të jetë: "... që pronarëve të tokave, bujqve, a mund të jepet subvencion për farë dhe pleh që kanë më pak se dy hektarë tokë."

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e tretë, duke cekur se në vend të fjalës *perfade* është shkruar fjala *profite*.

Kreshnik Ahmeti bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e pestë “Propozimrregulloren për rendin e brendshëm në Parkun e Gërmisë”, duke shtuar se nuk janë përfshirë propozimet të cilat i kam dhënë në emër të grupit parlamentar. Po ashtu kanë qenë tri propozime dhe kam pasur një pyetje për sqarim, por nuk kam marr përgjigje as atë ditë, e as me shkrim.

Visar Arifi bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e pestë, duke cekur se pyetjen që e kam bërë lidhur me qentë, se si duhet me qenë të lidhur, pasi sipas Rregullores për rendin e brendshëm në Parkun e Gërmisë nuk ka qenë e qartë sa duhet, nuk kam marr përgjigje as atë ditë, as deri sot.

U konstatua se me shumicë votash, me ndryshime dhe plotësime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit.

Pika e dytë

Njëzëri u miratua Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2014.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozmplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes “Sofalia” në Prishtinë, arsyeshmërinë për ndryshimin dhe plotësimin e këtij plani, e paraqiti Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Përfaqësuesja e kompanisë “Vizion Projekt”, **Jona Burrja**, në mënyrë elektronike bëri prezantimin e Planit rregullues të lagjes “Sofalia”, duke elaboruar disa prej komponentëve më kryesor rreth ndryshimit dhe plotësimit të këtij plani.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi analizuar këtë material dhe parimisht ne do ta përkrahim që ky propozimvendim të dalë dhe të shkojë për diskutim publik, por i kemi edhe vërejtjet tona që i kemi dhënë brenda grupit.

Si shqetësim më i madh për ne është shiriti gjelbërues, që është i paraparë në rrugën kryesore prej pjesës që tango me pronën komunale, deri te pjesa e unazës, që është thujse te Liqeni i Gërmisë, ana e djathtë. Këtë po e them për shkak se në këtë pjesë është një numër bukur i madh i objekteve të ndërtuara çoftë me leje, çoftë edhe pa leje, të cilat janë në proces të legalizimit. Kërkoj të dija se përfaqësuesit e kompanisë a janë konsultuar me hartuesit e Planit zhvillimor urban, edhe te shohin se a është inkorporuar Plani zhvillimor në Planin zhvillimor urban, andaj dhe është dashtë që edhe kjo pjesë këtu të trajtohet dhe të shikohet se si të veprohet tutje.

Ylli Hoxha tha se janë dy çështje që janë tejet shqetësuese, e që kanë të bëjnë me rripin e gjelbër.

E para, mendoj që duhet Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të merret seriozisht me mënyrën se si janë lëshuar ato leje, ta analizojë se kush i ka lëshuar ato

leje, e të merr njëfarë përgjegjësie lidhur me atë veprim, se nuk është bërë mirë që është krijuar ajo gjendje. Çështja e dytë, ka të bëjë po ashtu me shpronësimin. Në një prej dokumenteve që e kemi shqyrtuar, në vazhdim të këtij rripi kanë dal dy parcela, të cilat realisht kanë qenë të shpronësuara, por janë kthyer në pronë private në proces të falsifikuar. Kërkoj nga Komuna që brenda këtij procesi, të verifikoj nëse është shpronësuar ndonjëherë ky rrip i gjelbër, e nëse po, atëherë si është e mundur që këto toka të kthehen në pronë private. Mendoj se është një proces që duhet ta ndjekim paralelisht me këtë diskutim. Ne si grup do ta përkrahim, megjithatë të futet në diskutim publik.

Laura Zherka, në emër të GP të PDK-së, tha se e kemi shqyrtuar këtë projektplan rregullues dhe se për plotësimin e këtij plani kemi dhënë disa vërejtje apo propozime. Sipërfaqja e kësaj zone në këtë dokument, nuk është paraqitur në metra katrorë apo në hektarë, kur dihet se ka më tepër zonë publike apo shoqërore. Po ashtu si tjetër propozim për plotësim të këtij dokumenti, mendojmë që është edhe tek skenarët, dhe mendoj se janë thelbi i një dokumenti të planifikimit. Tek skenarët tërësitë që janë ndarë nëpër zona, secila tërësi parashihet objekte, ndërtim i objekteve. Te etazhiteti, duhet pak më tepër me u fokusuar në këtë drejtim, kur e dimë se kjo zonë ka më tepër pejsazhe të bukura gjelbërimi. Po ashtu edhe bashkëpunimi me komunën të jetë pak më preciz. Do të ishte mirë që të precizohen objektet publike ku do të ndërtohen në ngastra, pra të saktësohet ku do të jetë qendra e kulturës, terrenet e sportit e të gjitha këto etj. Si grup parlamentar, mendojmë se duhet të vazhdojmë tutje, mirëpo duke i marr parasysh të gjitha këto vërejtje dhe propozime.

Islam Pacolli ceku se, sa i përket hapësirës gjelbëruese për të cilën po debatohet, mendoj se për atë zonë nuk është e mjaftueshme. Kjo duhet të shqyrtohet ende dhe të shtohet gjelbërimi dhe pjesa rekreative, kështu që të përmirësohet vërtetë dhe mos të ndryshon emërtimin apo kahjen. Është shqetësuese në rast se ka pronë të uzurpuara dhe nëse ka pronë të tilla, kishte me qenë mirë që ato të lirohen, t'i jepet hapësira publike qytetarit, për arsye që hapësira publike është e të gjithë qytetarëve. Sugjeroj që kjo zonë të mos ngarkohet me mbindertime, të planifikohet një infrastrukturë adekuate dhe të parashihet që të bëhet përnjëherë, në mënyrë që mos të ketë ndërhyrje prapë pas një kohe për ndryshime, sepse çdo herë po shkon buxheti tek infrastruktura e dyfishtë. Si grup parlamentar e përkrahim që të dërgohet në shqyrtim publik.

Imer Rusinovci tha se e kemi shqyrtuar me kujdes këtë material, normalisht që e përkrahim çdo iniciativë, përkatësisht çdo plan rregullues që është konformë kritereve të mirëfillta. Jemi të shqetësuar për një dukuri, që po më duket se parafolësit nuk e potencuan deri më tash. Nuk ka lidhje që një Kuvend komunal i kaluar ka qenë me një garniturë tjetër njerëzish ose me departamente tjera, por mendoj se funksionaliteti duhet të jetë i njëjtë. Në këtë konotacion, unë konsideroj se nuk kemi arsye dhe nevojë të përdorim standarde të dyfishta, përderisa një pjesë e caktuar e pronave private kanë leje ndërtimi, atëherë edhe pronarëve të tjerë legalë ose legjitim duhet t'iu takojë ose jo. Këto gjëra duhet t'i definojë d.m.th. ekipi i cili konsideroj që ka bashkëpunuar me hartuesit e planit të zhvillimit urba.

Si grup parlamentar e përkrahim që të dërgohet në diskutim publik.

Feti Mehdiu i përkrahu disa vërejtje dhe sugjerime, por dha edhe disa sugjerime në emër të subjektit të tij.

Sa i përket projektit të rrugës për të cilën u diskutua, ne mendojmë që duhet pasur kujdes pak më shumë, në mënyrë që rrugët të jenë sa më të gjëra. Konkretisht, përballë Shkollës Normale, një mur që është aty, ndërtohet një objekt, sugjeroj që kompania ta ketë parasysh në çoftë se ai ndërtim do të realizohet aty ku është muri dhe në realitet aty mungon hapësira për një trotuar për këmbësorë. Uroj edhe njëherë për këtë dhe gjithësesi të merret parasysh harmonizimi i realizimit të atij projekti si e shohin kompania me inspektionin, që mos të bëhet korrigjim pas dy apo tri vite, për shkak se ato korrigjime kushtojnë.

Si grup parlamentar e përkrahim që të dërgohet në diskutim publik.

Abetare Fazliu theksoi se me disa plotësime që i dhanë të tjerët, edhe ne e përkrahim dhe mendojmë se duhet të shqyrtohet dhe të vazhdojë që të del në diskutim publik, që edhe ata të mund të kenë ndonjë sugjerim apo diçka që të shtojnë.

Visar Arifaj ceku se është shumë ide e mirë, sidomos pjesa e shiritit të gjelbër, duke e pasur parasysh që Sofalia nuk është vetëm një lagje, një lagje tjetër e Prishtinës, por për faktin që e lidh Parkun e Gërmisë me qytetin. Duhet analizuar ndoshta shumë më detalisht sesa ka me qenë funksionale kjo pjesa që e lidh pjesën tjetër të qytetit me Gërminë, sepse nëse këtu nuk bëhet punë e mirë, atëherë njerëzit kanë me prituar shumë me shkuar në Gërmi, ashtu si është sot. Edhe ne e përkrahim që kjo të vazhdojë në diskutim publik.

Nenad Miladinovic e përkrahu propozimplanin që të dërgohet në diskutim publik.

Lidhur me këtë propozimplan diskutuan edhe **Agim Gashi, Shemsi Veseli, Shefki Gashi, Hatixhe Latifi Pupovci, Kimet Zeqa, Lirak Çelaj, Flamur Shala, Sadri Ramabaja, Muhamet Selmani, Sylejman Pireva, Shiqeri Spahiu, Fadil Gashi, Sami Hamiti, Liburn Aliu dhe Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Me shumicë votash, u miratua Vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia" në Prishtinë.

Pika e katërt

Lidhur me shqyrtimin e raportit financiar tremujor, për periudhën korrik - shtator 2014, për të hyrat dhe shpenzimet brenda këtij tremujori, të pranishmit i informoi Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës.

Sami Hamiti paraqiti disa vërejtje lidhur me këtë raport, duke thënë se brenda kësaj periudhe kohore të hyrat dhe shpenzimet janë në nivelin e duhur. Shqetësim më i madh normalisht që

është të investimet kapitale, sidomos prej granteve, ku realisht shpenzimi është shumë i ulët dhe si trend nuk do të arrihet. Nga kjo shihet se disa linja, apo zëra buxhetorë, janë të paprekura, ku në këtë kohë nuk është shpenzuar asnjë centë. Sipas parashikimeve, mund të konstatojmë se gjashtë apo deri në shtatë milion euro do të mbetën nga granti i nivelit qendror që do të shkojnë në suficit.

Yll Hoxha tha se edhe ne po ashtu i ndajmë disa prej shqetësimeve, që kanë të bëjnë me inkasimin e ultë të mjeteve, të cilat janë të pasqyruara në tabela, andaj dhe dua të theksoj se jo çdo e hyrë duhet të jetë e justifikueshme. Për mosrealizimin e projekteve me kohë, mendoj se një vrejje është edhe për Zyrën e prokurimit, do të thotë se ajo zyrë është duke sabotuar, ose nuk dinë me krye detyrën e vetë, andaj dhe në këtë drejtim kërkoj nga Kryetari që të ndermerr hapa konkret për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Lirak Çelaj theksoi se realizimi i buxhetit është një prej parametrave që mat preformancën e cilitdo institucion, atëherë mund të them që kjo qeverisje nuk ka performuar mirë. Natyrisht, ne duhet të krahasohemi edhe me vitet paraprake, për të cilat ne kemi qenë vazhdimisht të pakënaqur. Konsideroj që edhe brenda kësaj periudhe kohore, trendet të shpenzimi dhe të vjeljet nuk janë të knaqshme dhe nuk është marrë asnjë masë në përmirësimin e gjendjes.

Islam Pacolli potencoi se ne kemi kërkuar që në fillim që projektet kapitale të realizohen në maksimum, sepse grantet neve na ikin dhe për vitin e ardhëshum nuk kemi mundësi t'i kemi. Kërkoj që gjdo projekt që bëhet, sidomos në infrastrukturë, të mos jetë vetëm projekt ideor, por të jetë projekt realizues, i cili do ta kishte edhe një kosto më të vogël.

Imer Rusinovci shtoi se edhe ne i ndajmë disa shqetësime, në veçanti për trende jo normale konform realizimit të projekteve zhvillimore. Po ashtu, është një brengë tjetër e cila është e pranishme tek ne, për mundësinë e krijimit të suficitit nga granti qeveritar. Këto duhet të jenë disa nga vërejtjet, të cilat mund të bartin pasoja edhe në vitet tjera.

Feti Mehdiu shprehu përkrahje në parim për raportin financiar, jo me të gjitha ato vërejtje dhe sugjerime, por jemi që të gjitha ato projekte kapitale të cilat janë në program për realizim, duhet të vazhdohen ashtu si janë.

Abetare Fazliu, shprehu mendimin se do të ishte mirë që të shqyrtohet edhe një herë ky raport, e në veçanti të çështja e infrastrukturës.

Visar Arifaj tha se shqetësuese është çështja e shpenzimeve, mirëpo, në anën tjetër, nuk munden më mbetur tash pa u realizua asnjë projekt vetëm për shkak se nuk është në përputhje me qeverinë e re. Si anëtarë të këtij Kuvendi, kërkojmë një shpjegim pak më të qartë, pse shumë prej projekteve nuk janë realizuar.

Lidhur me Raportin diskutuan edhe **Muhamet Selmani, Shpend Ahemti, kryetar, Flamur Shala, Agim Gashi, Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, Kreshnik Ahmeti, Bekim Gashi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Vlora Dumoshi, Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës dhe Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.**

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se në sallë janë prezent tridhjetë e shtatë (37) anëtarë, andaj dhe mund të hedhet në votim **Raportin financiar tremujor, për periudhën korrik – shtator 2014.**

Sipas votimit, u konstatua se me gjashtëmbëdhjetë (16) vota për, tetëmbëdhjetë (18) kundër dhe tri (3) abstenime, nuk u miratua Raporti financiar tremujor, për periudhën korrik – shtator 2014.

Pika e pestë

Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës.

Pika e gjashtë

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemajlit, Kryetari tha se është propozim që të caktohet një lokacion, dhe propozoi që në këtë mbledhje të merret një vendim politik për vendosjen e shtatores, e pastaj mbetet që të diskutohet me Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për lokacionin e mundshëm.

U konstatua se njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemajlit dhe më pas, me një vendim të veçantë nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Ambientit, të caktohet lokacioni i mundshëm.

Pika e tetë

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Osman Dumoshit.

Pika e nëntë

Lidhur me Propozimvendimin për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko-privat, Kryetari tha se pas ndërtimit të rrethrotullimit në lagjen “Kalabria”, është parë më se e domosdoshme të ndërtohen edhe dy nënkalime, ku në hapësirën e tyre do të ketë edhe lokale të cilat do të merren me aktivitete afariste.

U konstaua se njëzëri u miratua vendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko-privat.

Pika e dhjetë

Për Propozimvendimin për subvencionimin e mjeteve financiare për studimin e natyrës në Parkun e Gërmisë, të pranishmit i njoftoi Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Njëzëri u miratua Vendimi për subvencionimin e mjeteve financiare për studimin e natyrës në Parkun e Gërmisë.

Pika e njëmbëdhjetë

U konstaua se njëzëri u miratua Rregullorja për hapjen e kutive të ankesave.

Pika e dymbëdhjetë

Lidhur me Informatën për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen “ Dodona “, të pranishmit në i informoi Visar Berisha. Ai tha se Grupi punues, i përbërë prej përfaqësuesve të Drejtorisë së Financave dhe Pronës, përfaqësues të pronarëve, përfaqësues të investitorit, një arkitekt i pavarur dhe gjithashtu përfaqësues të Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrotjes së Mjedisit, si përfundim për zgjidhjen e rastit të pronarëve ka propozuar tri variante, të cilat do t'i paraqesim para Kuvendit.

Varianti i parë ka të bëjë me këmbimin e pronës komunale, varianti i dytë ka të bëjë me realizimin e një partneriteti publik-privat dhe varianti i tretë, që ajo pjesë të shpallet zonë e interesit të veçantë.

Mustafë Krasniqi tha se do ta përkrahim zgjidhjen e kësaj çështje dhe në emër të Grupit parlamentar, në rast se si zgjidhje e propozuar është varianti i dytë, pajtohemi me këtë që të ecim tutje.

Ylli Hoxha falënderoi ekzekutivin që për një kohë të gjatë është marrë me një çështje delikate, e cila është reflektuar në hyrje të Komunës gati çdo ditë me protestë të banorëve. Ka qenë një proces i mundimshëm, por besoj që ja ka vlejtur, sepse alternativa e tij ka qenë një shkëmbim i pafavorshëm i pronës komunale. I kam analizuar tri zgjidhjet që janë propozuar, andaj

konsideroj që mbrojtja e interesit publik po ashtu duhet të jetë një prej kriterëve të rëndësishme brenda këtij debati. Uroj që sa më shpejt të zgjidhet ky proces dhe të përfundojë sa më mirë për të gjithë ne.

Laura Zherka, për propozimet e ofruara nga ekzekutivi, tha se duhet shqyrtuar, në mënyrë që ta ruajmë edhe pronën publike, edhe kërkesat e qytetarëve, sepse këta pronarë të tokave janë joshur me një vendim të mëhershëm.

Islam Pacolli tha se ne nuk e përkrahim një diçka që ka filluar jo ligjshëm, ta bëjmë të ligjshme. Mendimi ynë është që propozimi më i mirë kishte me qenë që të arrijmë ta bëjmë një pjesë të gjelbërimit, eventualisht, ne nëse kthehemi me ruajt të atëhershmen, atëherëdo të ishte mirë që aty mos të ketë ndërtime më të larta se P+2.

Imer Rusinovci shprehu përkrahje për të tri variantet e propozuara, por mbetet për tu analizuar se cila nga ato është më e mira.

Feti Mehdiu shtoi se varianti i dytë është i pamundur të realizohet në atë hapësirë, andaj pronarët duhet të diskutojnë me Drejtorinë dhe të shohin se cilin variant po e pranojnë ata, për shkak se është shumë delikate kjo. Varianti i tretë është më i përshtatshme dhe që i plotëson më shumë nevojat e këtij qyteti.

Abetare Fazliu tha se propozimi i dytë i dhënë nga grupi punues, është zgjidhja më e mundshme dhe se ne e përkrahim këtë propozim.

Visar Arifaj shprehu mendimin se varianti i dytë i propozuar nga grupi punues, nuk është zgjidhje e mirë, andaj varianti i parë ndoshta është më i favorshëm.

Lidhur me variantet e propozuara nga grupi punues për zgjidhjen e rastit të pronarëve, sqarime të nevojshme dha **Shpend Ahmeti, Kryetar**.

Për këtë pikë diskutuan edhe **Muhamet Selmani, Sami Hamiti, Qëndron Kastrati, Shefki Gashi, Sadri Ramabaja, Flamur Shala, Liburn Aliu, dhe Sylejman Pireva**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Duke pasur parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna lidhur me zgjidhjen e rastit të pronarëve në lagjen "Dodona", u arrit ky

Konkluzion:

"Çështja e zgjidhjes së rastit të pronarëve në lagjen "Dodona", mbetet që t'i kthehet edhe një herë ekzekutivit, përkatësisht më së shumti Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe

Mbrojtjes së Mjedisit, në pajtim me qytetarët të cilëve u janë rrënuar objektet dhe për një të mbledhjet e radhës, të përcaktohen saktë për një të prej varianteve të mundshme".

Pika e trembëdhjetë

Lidhur me Informatën për fillimin e procesit edukativo-arsimor 2014 - 2015, të pranishmit i informoi Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Për këtë pikë diskutuan edhe Agim Gashi, Hatixhe Pupovci, Kimete Zeqa, Qëndron Kastrati, Flamur Shala, Kreshnik Ahmeti, Ylli Hoxha, Sylejman Pireva, Feti Mehdiu, Remzi Pacolli dhe Sofije Bunjaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

U konstatua se u përkrah Informata për fillimin e procesit edukativo-arsimor 2014 - 2015.

Pika e katërbëdhjetë

Lidhur me Informatën rreth mbjelljeve vjeshtore, të pranishmit i informoi Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.

U konstatua se u përkrah Informata rreth mbjelljeve vjeshtore.

Pika e pesëmbëdhjetë

Pyetje dhe përgjigje.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nuk kishte pyetje nga anëtarët e Kuvendit drejtuar ekzekutivit të Komunës.

Pika e gjashtëmbëdhjetë

Të ndryshme.

Abit Kastrati, kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

- Kërkoj që, sipas mundësisë të vendosen disa pengesa në rrugët "Shaban Shala" dhe "Rifat Krasniqi", si dhe të bëhet ndriçimi në këto rrugë dhe në shumë rrugë të tjera në lagjen "Kodra e Trimave".

Mbledhja përfundoi në orën 18:15.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.